

Takim ndërmjet projektit JustAL dhe Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë në kuadër të mirëmenaxhimit të proceseve të punës

Në datat 18 – 19 tetor 2023, stafi i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, mori pjesë në workshopin e zhvilluar nga projekti JustAL në kuadër të mirëmenaxhimit të procesit të punës mbi dokumentat strategjik të Ministrisë së Drejtësisë.

Qëllimi i këtij takimi ishte fuqizimi i kapaciteteve të stafit të drejtorisë mbi elementët e administrimit, monitorimit dhe raportimit të zbatimit të strategjive të cilat hartohen dhe monitorohen nga Ministra e Drejtësisë. Sugjerimet e projektit JustAL mbi mjetet/metodat e shpjguara përgjatë këtyre ditëve, si dhe koordinimi ndërmjet Ministrisë të Drejtësisë dhe institucioneve raportuese, shërbyen për të zhvilluar situata konkrete mbi punën e drejtorisë.

